



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 4, datë 23.01.2019

PËR

**“ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ), NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 23.01.2019, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 03, datë 21.01.2019 “Mbi shkriren e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) aktual, të zgjedhur me VSA nr. 19, datë 18.03.2016 dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”; Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 322 prot., datë 14.01.2019 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018” (protokolluar në Institucionin tonë me nr. 86 prot., datë 16.01.2019) si dhe në shkresën e Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik me nr. 2 prot., datë 23.01.2019 “Mbi vënien në dijeni për kandidatët të cilët kanë aplikuar për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”, mbas zhvillimit të zgjedhjeve për anëtar të KIZ,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e 5 (pesë) anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve, si më poshtë vijon:

- Z/Znj. Andrea Cenaj, nga Fakulteti i Muzikës;
- Z/Znj. Alex Celoalija, nga Fakulteti i Artit Skenik;
- Z/Znj. Harri Aleksai, nga Fakulteti i Arteve të Bukura;
- Z/Znj. Gene Permeti, nga Fakulteti i Arteve të Bukura
- Leart Bazimi, përfaqësues i studentëve. FM



2. Zgjedhjen e Sekretarit/es të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, si më poshtë vijon:

- Zikuj. Viktor Ferraj, nga Fakulteti i Arteve të Bukura

3. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), i Universitetit të Arteve, mbas marrjes së vendimeve nga ana e Senatit Akademik, për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" si dhe për zëvendësimin e 2 (dy) anëtarëve të Senatit Akademik kategoria student, pasi anëtarët aktual kanë përfunduar studimet në UART, mbështetur dhe në Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në UART.

4. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.

5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI



Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

ProfAsoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI